RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0096/26
Data 22.07.2026
PRISHTINË

RTK

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Konkluzat, Vendimet, Rekomandimet dhe Kërkesat e nxjerra në mbledhjen e Bordit të RTK-së, me datë 22.07.2026

1. Me 9 (nëntë) vota për, asnjë votë kundër, aprovohen procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura në datat: 05.05.2026, 13.05.2026, 17.05.2026.
2. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme që, përmes Drejtorit të Festivalit të Këngës në RTK për vitin 2026, pas përfundimit të festivalit, të përgatitet dhe t'i përcillet Bordit një Analizë Post-Festival, me theks të veçantë në analizën e shpenzimeve afatshkurtra dhe afatgjata, efikasitetin e përdorimit të mjeteve dhe aseteve, si dhe mundësitë për optimizim e kostove në edicionet e ardhshme.
3. Me 9 (nëntë) vota për, dhe asnjë votë kundër, miratohet Rishikimi i Projeksionit Buxhetor për organizimin e Festivalit të Këngës në RTK për vitin 2026, i miratuar në parim nga Bordi përmes votimit elektronik me datë 05.06.2026.
4. Me 9 (nëntë) vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim, miratohet raporti financiar i shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë janar - qershor 2026.
5. Me 9 (nëntë) vota për dhe asnjë votë kundër, miratohet propozimi i u.d. Drejtoreshës së Përgjithshme të RTK-së për shfuqizimin e Pikave 7 dhe 8 të Konkluzave, Vendimeve, Rekomandimeve dhe Kërkesave të miratuara në mbledhjen e Bordit të RTK-së, të mbajtur me datë 02.12.2024, lidhur me ndalimin e sistemimeve, risistemimeve të stafit të RTK-së që kanë implikime financiare, si dhe rekrutimeve përmes konkurseve publike dhe avancimeve të stafit të RTK-së.
6. Me 9 (nëntë) vota për dhe asnjë votë kundër, miratohet propozimi i u.d. Drejtoreshës së Përgjithshme të RTK-së për kryerjen e një auditimi, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së angazhimeve shtesë, pagesave për orët shtesë dhe autorizimeve përkatëse, përfshirë verifikimin e përputhshmërisë së tyre me Rregulloren Nr. 1363/18 Metodologjia e përcaktimit të ndërlikueshmërisë së vendeve të punës, aktet e tjera të brendshme relevante në fuqi, si dhe Vendimin Nr. 0133/24, të dates 02.12.2024.
7. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme që, përmes Drejtorit të Festivalit të Këngës në RTK për vitin 2026, të sigurojë që çdo mall ose shërbim i nevojshëm për realizimin e festivalit, që kalon vlerën mbi 1,000.00 € dhe që ka përdorueshmëri më shumë se një vit, duke marrë për bazë edhe precedentët e dy edicioneve të para të festivalit, i cili mund të trajtohet si investim kapital dhe mund të përdoret në edicionet e ardhshme, të kategorizohet si investim kapital, me qëllim të optimizimit të kostove në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme.

8. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme që, përmes Drejtorit të Festivalit të Këngës në RTK për vitin 2026, të sigurojë angazhimin e burimeve të brendshme njerëzore të RTK-së për nevojat e festivalit, me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve dhe sigurimit të vetëqëndrueshmërisë së festivalit, duke shmangur angazhimet e jashtme kur shërbimet mund të realizohen nga kapacitetet e brendshme.
9. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme që, përmes Drejtorit të Festivalit të Këngës në RTK për vitin 2026, të sigurojë që punonjësit e angazhuar për nevojat e festivalit të lirohen nga detyrat e tyre të rregullta sipas kontratës së punës, për periudhën e angazhimit në festival, pa krijuar kosto shtesë, përveç rasteve përjashtuese kur lirimi nga detyrat e përcaktuara nuk është i mundur.

Dardan Begiri

Kryetar i Bordit të RTK-së